



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 108/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Rafet Haxhaj dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e Myrvete Shurdhani, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), në seancën e panelit të mbajtur me 25.09.2013, mori këtë:

V E N D I M

Konsiderohet e tërhequr ankesa Anr. 108/2013 datë 19.09.2013 e Myrvete Shurdhani, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Prishtinë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR).

Arsyetim

PZAP, ka pranuar një kërkesë për tërheqje të ankesës nga Myrvete Shurdhani, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Prishtinë, nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), më datë 21.09.2013, me të cilën pala ankuese kërkon që mos të shqyrtohet ankesa e lartcekur, me arsyetimin se pas konsultimit me familjen e saj dhe partinë e saj ka vendosur të qëndroj si kandidate për anëtare të kuvendit në Prishtinë në listën e subjektit politik AKR.

PZAP-i pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës Anr. 108/2013, me të cilën kërkohet nga PZAP-i, që të mos ta shqyrtoj ankesën në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 108/2013 më datën 25.09.2013

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi

